# DËSHMI ARKIVI

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

**A-394026**
VERSIONI

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Dash Shehi: Vajtja e Berishës në SHBA nuk ndryshon gjë për opozitën, si do ta rrëzojë Ramën kur ka probleme me SPAK |
| ADRESA | `https://www.gazetatema.net/politika/dash-shehi-vajtja-e-berishes-ne-shba-nuk-ndryshon-gje-per-opoziten-si-d-i584106` |
| BURIMI | gazetatema.net |
| GJENDJA | redirected |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 5 shtator 2026, 12:09:17 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 5 shtator 2026, 12:15:00 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `742666febe79eedc2cd9a40ffb6de36ccc611d472f49e8453be1a6d7415ea134` |
| TEKSTI | `a7ddc666499a17c99f4ab9b38a50ae34aea9e59094fa0daf83c97d2b39440476` |
| PAMJA | `a5311c3382c38e07a0cdcc45c9553498cb11258d568d0f0b180be7f7a98237cf` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `b0ddc3c0aeb1644380873fdeffd208da3c07d0a65d1ea99a03213ab2cd29e8cb` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | `82597d84b51b00d12dc8da6bd19ef563dde476bcf2b8ac3fbaec8c83c315f326` |
| ANKORUAR | Polygon PoS · bllok 46991200 |
| TRANSAKSIONI | `0x4a6949f734bb917e86ef48a394a39f5e560c6ca7cb50992564901c0d93c74ab3` |
| IPFS | `QmcQ2vpHEy67KT56kkLrEBokuUFGqg7MP3SJ63znFCszpz` |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/b0ddc3c0aeb1644380873fdeffd208da3c07d0a65d1ea99a03213ab2cd29e8cb`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

# Dash Shehi: Vajtja e Berishës në SHBA nuk ndryshon gjë për opozitën, si do ta rrëzojë Ramën kur ka probleme me SPAK

TemA
5 Shtator 2026, 14:15Politika TEMA



Një sukses për Berishën, por jo për opozitën e cilëson kreu i LZHK-së Dashamir Shehi vizitën e kryedemokratit në SHBA pas heqjes së non gratës. Në studion e Off the Record me Andrea Dangllin në A2 CNN, Shehi paralajmëroi 3 ditë më parë se votat e opozitës po tkurren gjithnjë edhe më shumë.

*"Ndryshon për Berishën, për opozitën nuk ndryshon ndonjë gjë e madhe. Si grata dhe non grata, Berisha politikën e ka bërë, Partinë Demokratike, vulën e selinë e mori. Në zgjedhje ka hyrë. Në qoftë se këto vota që qenë 600 e sa mijë u bën 500.000, herën që vjen bëhen më pak. Edhe unë kam frikë që kështu do të ndodhë. Kështu që unë nuk kam shpresë që kjo zgjidh gjë në rrafshin opozitar. Shpresën e kam te këto të rinjtë, te këto lëvizjet e reja",* tha Shehi në Off the Record me Andrea Dangllin në A2 CNN.

Pas kësaj Shehi i sugjeroi Berishës t'i japë zgjidhje bllokut opozitar dhe ta kuptojë që është jashtë ligjësive politike.

*"Unë do të doja që mbasi i mbylli këto, të ketë një gjykim tjetër shumë më të ftohtë politikisht. Ta kuptojë që është jashtë ligjësisë politike. Nuk mund të rikthehesh pas tre herësh. Nuk ndodh. Nuk ka ndodhur. Kjo është një ligjësi e politikës. Është ligjësia e natyrës. Që kur ka një limit jeta edhe fizike, biologjike",* u shpreh Shehi.

Në këto kushte ai i solli në vëmendje kryeopozitarit përballjen me SPAK, një problem që sipas Shehit e dëmton opozitën për të ardhur në pushtet përballë kundërshtarit politik.

*"Si do marrësh përsipër ti që do i drejtoje këta njerëz? Çfarë do bëjë ky? Pretendon kryeministrin Shqipërisë. Ti je i pari i këtij grupi, do shkosh ta drejtosh deri në çfarë viti? Pastaj ti kur vetë je nën probleme me SPAK. Siç thërrasin këta (të mazhorancës) në SPAK, të thërrasin edhe ty në SPAK. Dhe fillon të çarmatosesh. Me çfarë armësh do t'i biesh kundërshtarit? Duhet një analizë tjetër për këtë punë. Edhe nuk vlejnë këto lavditë e këto dekoratat, janë personale. Po kur do marrësh përsipër misionin që kjo qeveri do rrëzuar me të gjitha kushtet, një nga kushtet është që mos jesh ti tabela e qitjes që ky Edi Rama të thotë që po iki unë po kush do vijë. Në qoftë se kjo punë e pengon rrëzimin e tij, gjykoj që opozita në mënyrë të detyrueshme, jo të natyrshme, po të detyrueshme duhet të gjejë një trajektore të re politike".*

---

## Lini një Përgjigje

Lini një Përgjigje

Koment *

Emër *

POSTOJE KOMENTIN

['Të dëgjojnë babanë dhe nënën', Rama me batuta për zgjerimin e BE-së: '7 fëmijët e Ursulës' të ulen në tryezë! Ja si duhet të funksionojë integrimi gradual]

14:05 Politika

Rama nga Italia: Integrimi gradual, e vetmja mënyrë për të hyrë në BE! S'na duhet vetoja për t'u ulur në tryezë

13:45 Politika

[Kronika shfaq prani besnike ndaj atyre që mbeten përsëri me gisht në gojë!]

13:22 Politika / 2 komente

[Kokalari shpërthen pas lejimit të Berishës në SHBA: Do të ekspozoj çfarë fshihet pas vendimit]




Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.